



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 621/1 Prot.

Tiranë, më 13.04.2021

V E N D I M

Nr. 61, Datë 13.04.2021

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 158, datë 28.12.2020, të paraqitur nga Qendra “Konsumatori Shqiptar” në bashkëpunim me Qendrën “Durrës Aktiv” kundër Bashkisë Durrës, në të cilën pretendohet diskriminim për shkak të “vendbanimit¹” të banorëve të zonës së ish-Kënetës,² në rrugën “Gjelbërimi” dhe rrugën “Azem Hajdari”. Në vijim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna³, subjekti ankuesi në mes të tjerash informon se: *“Zona e ish-Kënetës në Bashkinë Durrës është një nga zonat e populluara nga një komunitet i ardhur aty prej shumë vitesh nga zona të ndryshme të Shqipërisë. Banorët janë në bashkëjetesë të plotë me njëri-tjetrin, pa ndjerë dallime apo frymë diskriminuese mbi bazë prejardhje apo përkatësie shoqërore. Kjo situatë çënohet nga investimet e bëra nga Bashkia Durrës në këtë zonë dhe pikërisht tek popullsia që banojnë në rrugën “Gjelbërimi” dhe rrugën “Azem Hajdari”. Në këtë zonë mungojnë investimet bazike si: kanalet e ujërave të zeza, ndriçimi publik dhe gjelbërimi. Gjithashtu banorët shprehen se drejtuesit e institucioneve vendore si dhe nëpunësit publikë*

¹ Pretenduar nga subjekti ankues me e-mail-in datë 28.01.2021.

² Me e-mail-in datë 30.12.2020 dhe shkresën nr. 127, datë 19.01.2021, është kërkuar nga subjekti ankues identifikimi i shkakut të diskriminimit dhe informacion plotësues.

³ Referuar formularit të ankesës, datë 28.12.2020 dhe informacionit të dërguar me e-mail, datë 28.01.2021.

përdorin gjuhë diskriminuese ndaj këtyre banorëve, duke i konsideruar si të ardhur apo etiketime të tjera”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave nga ana e Bashkisë Durrës për krijimin e kushteve për një jetesë sa më cilësore për banorët e zonës së ish-Kënetës duke planifikuar investime në kanalizime, ndriçim dhe gjelbërim.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Qendra “Konsumatori Shqiptar”, është një organizatë jofitimrurëse, regjistruar si person juridik, me vendimi nr. 927, datë 01.10.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Bazuar në ankesën e paraqitur Qendra “Konsumatori Shqiptar” nuk pretendon se është cënuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtëpërdrejtë, por parashtron se mosveprimet dhe qëndrimet e Bashkisë Durrës kundrejt banorëve të zonës së ish-Kënetës, janë diskriminuese.

Bazuar në nenin 32/1/b, të LMD-së, të ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Komisioneri ka kompetencë: b) të shqyrtojë ankesat nga organizatat që kanë interes të ligjshëm për të vepruar në emër dhe me pëlqimin me shkrim të individëve ose grupeve të individëve që pretendojnë se ka ndodhur diskriminimi ose në emër të tyre për çështje që lidhen me interesa kolektivë”.*

Bazuar në statutin e Qendrës “Konsumatori Shqiptar”, ajo është një organizatë jofitimrurëse e krijuar, ndër të tjera me qëllimin që të përfaqësojë dhe të promovojë interesat e konsumatorëve individualë dhe kolektivë shqiptarë, përballë tregtarëve, organeve të administratës publike dhe çdo strukture tjetër. Qendra e zhvillon aktivitetin e saj pa kufizim në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë dhe jashtë tij.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se provohet lidhja e detyrueshme, e drejtëpërdrejtë që duhet të ekzistojë ndërmjet veprimtarisë së ankuesit dhe çështjes që kjo organizatë ka paraqitur, duke vlerësuar përfundimisht se ankuesi legjitimohet para Komisionerit për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Në nenin 1 të Ligjit 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Neni 3, i Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ndalon çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur nga neni 1, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët,

të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi. Ndërsa, në Kreun II, të ligjit parashikohet mbrojtje e posaçme nga diskriminimi në fushën e të mirave dhe shërbimeve. Ky ligj në nenin 20, pikat 1 dhe 2, të tij parashikon se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”*.

Neni 7 i LMD-së⁴, në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr. 158, datë 28.12.2020, të Qendrës “Konsumatori Shqiptar” dhe organizatës “Durrës Aktiv” kundër Bashkisë Durrës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 128, datë 19.01.2021, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Bashkia Durrës për ankesën e bërë nga Qendra “Konsumatori Shqiptar”. Në mënyrë të specifikuar është kërkuar:
 - Argumentet e Bashkisë Durrës, lidhur me pretendimet e subjektit ankues.
 - Informacion dhe kopje të dokumentacionit provues për investimet e kryera gjatë 4 viteve të fundit nga ana e Bashkisë Durrës, në zonën e ish-Kënetës, dhe në lagje të tjera të Bashkisë Durrës, lidhur me sistemimin e kanaleve të ujërave të zeza, ndriçimin publik dhe gjelbërimin.

⁴ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të ndryshuar.

- Kopje të projekteve të parashikuara, lidhur me investimet në kanalizime dhe trajtimin e ujërave të zeza, sigurimin e ndriçimit në rrugë dhe për gjelbërimin, për vitet 2021-2023, në zonën e ish-Kënetës dhe në lagjet e tjera të Bashkisë Durrës.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR614909296AA, datë 20.01.2021 rezulton se shkresa sipërcituar është marrë në dorëzim nga Bashkia Durrës, e cila ka marrë dijeni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar nga punonjësja e këtij Institucioni, ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

- Në mungesë të përgjigjes së Bashkisë Durrës, nëpërmjet shkresës me nr. 359, datë 23.02.2021, Komisioneri i është drejtuar sërish, përmes një shkrese kujtese për dërgimin e informacionit, duke e njoftuar përsëri që brenda datës 01.03.2021 të paraqesë parashtrimet mbi çështjen në fjalë.

Referuar dokumentit, Lajmërim marrje poste nr: RR618935067AA, datë 24.02.2021 rezulton se shkresa sipërcituar është marrë në dorëzim nga Bashkia Durrës, e cila ka marrë dijeni për shkresën e mësipërme, në kushtet kur dokumenti është nënshkruar nga punonjësja e këtij Institucioni, ashtu dhe nga nëpunësi i shërbimit postar.

Në vijim, Bashkia Durrës, pavarësisht faktit që ka marrë informacion lidhur me shkresat e sipërcituara, nuk ka depozituar asnjë dokument apo parashtrim lidhur me sa ka kërkuar Komisioneri në kuadër të shqyrtimit të ankesës në fjalë.

Me shkresën nr. 465/1, datë 11.03.2021 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka njoftuar Bashkinë Durrës me Vendimin nr. 43, datë 11.03.2021, në të cilin institucioni i Bashkisë Durrës është gjobitur në vlerën 200.000 (dyqind mijë) lekë për mosdhënien e informacionit dhe dokumentacionit të kërkuar zyrtarisht nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në lidhje me shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga Qendra “Konsumatori Shqiptar”.

Me shkresën nr. 3102/1, datë 18.03.2021, Bashkia Durrës ka informuar Komisionerin se është përgjigjur me shkresën nr. 15186, datë 18.12.2020, bashkëlidhur. Në shkresën bashkëlidhur nr. 490, datë 14.01.2021, Bashkia Durrës i ka kthyer përgjigje shkresës nr. 15186, datë 18.12.2020, të Qendrës “Durrës Aktiv”, në të cilën i ka bërë me dije se Bashkia Durrës ka përfshirë në buxhetin e vitit 2021, hartimin e projektit të zbatimit, për rehabilitimin e kanalit që përshkon zonën e Kënetës dhe pas përfundimit të hartimit të projektit dhe llogaritjes së preventivit, Bashkia do të drejtojë kërkesën për financimin e zbatimit të tij, pranë institucioneve përkatëse të qeverisë qendrore.

Për sa më sipër, Bashkia Durrës nuk vendosi në dispozicion të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, asnjë informacion dhe dokumentacion të kërkuar me shkresat, nr. 128, datë 19.01.2021 dhe nr. 359, datë 23.02.2021.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, disfavorizues dhe të pabarabartë.

Në ankesën nr. 158, datë 28.12.2020, të Qendrës “Konsumatori Shqiptar” pretendohet diskriminim i banorëve të zonës së ish-Kënetës, në rrugën “Gjelbërimi” dhe rrugën “Azem Hajdari”, për shkak të vendbanimit, nga ana e Bashkisë Durrës.

Pretendimi për diskriminim i shoqatës ankuese mbështetet në faktin se Bashkia Durrës nuk ka kryer investimet bazike si: kanalet e ujërave të zeza, ndriçimi publik dhe gjelbërimin e zonës në rrugën “Gjelbërimi” dhe rrugën “Azem Hajdari”.

Nga informacioni i vënë në dispozicion nga shoqatat ankuese, nga media⁵ por dhe nga vetë Bashkia Durrës⁶ rezulton se, është fakt i provuar dhe i pranuar nga të dyja palët në proces që në zonën e ish-Kënetës, nuk është investuar për sistemimin e kanaleve të ujërave të zeza, në sigurimin e ndriçimit publik dhe në investime për sigurimin e hapësirave të gjelbëra publike. Situata e rënduar mjedisore e banorëve të kësaj zone është bërë publike që në datë 15.09.2017, kur në emisionin “Stop” në TV Klan banorët e zonës kanë denoncuar situatën dhe kanë kërkuar nga Bashkia Durrës, që të sistemojë kanalizimin e ujërave të zeza dhe pastrimin e gjelbërimin e zonës. Pra, situata e vështirë mjedisore e kësaj zone ekziston prej shumë vitesh dhe Bashkia Durrës nuk ka dhënë asnjë informacion, nëse në këtë zonë janë kryer apo mendohet të realizohen ndonjëherë investime në rrjetin e kanalizimeve të ujërave të ndotura dhe pastrimin e gjelbërimin e zonës.

Neni 23, i Ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” parashikon shprehimisht funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike. Në këtë nen parashikohet se:

Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për:

1. *Prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm.*
2. *Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.*
3. *Mbledhjen dhe largimin e ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara.*
4. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e rrugëve vendore dhe sinjalizimit rrugor, të trotuareve dhe shesheve publike vendore.*
5. *Ndriçimin e mjediseve publike;*
6. *Transportin publik vendor.*

⁵ <https://tvklan.al/ish-keneta-durres-kthehet-ne-origjine-banoret-jetojne-mbi-ujrat-e-zeza/>, <https://stop.tvklan.al/shkozet-banoret-ankohen-per-kanalin-e-ujrave-te-zeza-dhe-infrastrukturen-stop-16-tetor-2020/>, <https://www.durres.gov.al/bashkia/zyra-e-shtypit/1355-kryetarja-e-bashkise-se-durresit-emiriana-sako-takon-banoret-e-zones-se-ish-kenetes-do-te-hartohen-projektet-per-rikonstruksionin-e-kater-rrugeve-te-zones>, <https://www.youtube.com/watch?v=RGVHWxZHHA4>.

⁶ Referuar shkresës nr. 490, datë 14.01.2021 të Bashkisë Durrës, në të cilën deklarohet se, ka përfshirë në buxhetin e vitit 2021, hartimin e projektit të zbatimit, për rehabilitimin e kanalit që përfshikon zonën e ish-Kënetës.

7. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e varrezave publike, si dhe garantimin e shërbimit publik të varrimit.*
8. *Shërbimin e dekorit publik.*
9. *Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike.*
10. *Mbledhjen, largimin dhe trajtimin e mbetjeve të ngurta dhe shtëpiake.*
11. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar, me përjashtim të shkollave profesionale.*
12. *Administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.*
13. *Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të shërbimeve të tjera në fushën e shëndetit publik, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.*
14. *Planifikimin, administrimin, zhvillimin dhe kontrollin e territorit, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.”*

Për sa më sipër, rezulton se Bashkia Durrës është autoriteti përgjegjës në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, në territorin e juridiksionit të saj. Përgjegjësitë e saj lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura; ndriçimin e mjediseve publike; parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike; etj.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me ligjin ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me ankesën, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimet e shoqatave për trajtim diskriminues të banorëve të zonës së ish-Kënetës.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurës Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi, i ndryshuar, në nenin 32/2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i është ofruar mundësia që të japë shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga shoqatat.

Bashkia Durrës, dështoi të provonte para Komisionerit se ka bërë përpjekjet e duhura dhe të domosdoshme për rregullimin e situatës jetike për banorët e zonës së ish-Kënetës.

Në këto kushte, referuar dokumentacionit të administruar, Bashkia Durrës, nuk vuri në dispozicion të KMD-së, asnjë informacion dhe dokumentacion për investimet e kryera gjatë 4 viteve të fundit dhe projektet e parashikuara për vitet 2021-2023, lidhur me sistemimin e kanaleve të ujërave të zeza, ndriçimin publik dhe gjelbërimin, në zonën e ish-Kënetës.

Referuar kronikave në media dhe deklaratave të banorëve, të referuara më sipër (shënimit në faqe 5), vërtetohet se situata mjedisore e banorëve të zonës është e rëndë si rezultat i papastërtive dhe grumbullimit të ujërave të zeza që derdhen në kanalën që kalon në atë zonë. Banorët ankohen për mos mbledhjen e plehrave, aromën e rëndë dhe mosfunksionimin e ndriçimit të rrugëve për të cilat banorët shprehen se janë vendosur shtyllat që në vitin 2018 por dritat nuk janë ndezur asnjëherë. Situata e rëndë mjedisore e zonës pranohet dhe nga Bashkia Durrës⁷, kur me shkresën nr. 490, datë 14.01.2021, ka informuar Qendrën “Durrës aktiv” se ka përfshirë hartimin e projektit për rehabilitimin e kanalit në buxhetin e vitit 2021.

Për sa më sipër, mungesa e sistemimit të ujërave të zeza, ndriçimit të rrugëve dhe gjelbërimit të zonës, është fakt i njohur prej kohësh, për të cilat Bashkia Durrës, nuk ka marrë asnjë masë për t’i dhënë zgjidhje. Mospërmbushja e detyrimeve të sanksionuara në legjislacionin shqiptar, ka vendosur banorët e zonës së ish-Kënetës, në pozita të pafavorshme dhe Bashkia Durrës ka dështuar në marrjen e masave të duhura për përmirësimin e kushteve të jetesës të këtyre banorëve.

Në interpretim të nenit 7, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri vlerëson se banorët e zonës së ish-Kënetës, në rrugën “Gjelbërimi” dhe rrugën “Azem Hajdari”, i janë nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Durrës.

B. Shkaku i mbrojtur “vendbanimi”.

Në ankesën nr. 158, datë 28.12.2020, të Qendrës “Konsumatori Shqiptar” pretendohet diskriminim i banorëve të zonës së ish-Kënetës, në rrugën “Gjelbërimi” dhe rrugën “Azem Hajdari”, për shkak të vendbanimit, nga ana e Bashkisë Durrës.

“Vendbanimi” është një prej shkaqeve, për të cilat, Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet*

⁷ Referuar dhe intervistës së dhënë në emisionin “Stop” të datës 15.09.2017, nga Kryeinxhinieri i Shoqërisë Ujësdedhës Kanalizime Durrës, z. G. D.

gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në rastin konkret, Komisioneri gjykon se “vendbanimi” konsiderohet si një shkak i mbrojtur, pasi jo vetëm parashikohet si i tillë në bazën ligjore të sipërpërmendur, por edhe sepse ekzistojnë prova, që e justifikojnë si të tillë.

Nëse vendbanimi është një shkak i cili është shprehimisht i përcaktuar si shkak i mbrojtur nga Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Komiteti për të drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, në Komentin e Përgjithshëm nr. 20 “*Mbi mosdiskriminimin në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*”, shprehet se vendbanimi përbën një shkak të mbrojtur nën ombrellën e termit “për çdo shkak tjetër”. Sipas pikës 34, të Komentit të Përgjithshëm nr. 20, të Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, pabarazitë midis lokaliteteve dhe rajoneve duhet të eliminohen në praktikë duke siguruar, për shembull, që ka shpërndarje në disponueshmëri dhe cilësi, e në rastin konkret që ka disponueshmëri dhe cilësi të kushteve mjedisore për banorët që ndodhen në zonën e ish-Kënetës.

Subjektet ankues, banorë të rrugës “Gjelbërimi” dhe “Azem Hajdari”, në zonën e ish-Kënetës, pretendojnë se janë trajtuar në mënyrë diskriminuese, nga ana e Bashkisë Durrës, për shkak të vendbanimit të tyre, i cili rezulton të jetë në zonën e ish-Kënetës në afërsi të kanalit që përshkon këtë zonë.

C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezulton se banorët e zonës së ish-Kënetës, në rrugën “Gjelbërimi” dhe rrugën “Azem Hajdari”, i janë nënshtruar një trajtimi të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Durrës, pasi këtyre banorëve nuk u janë siguruar nevojat bazë për një jetesë normale, të tilla si rrjeti i kanalizimit të ujërave të zeza, ndriçimi i rrugëve dhe gjelbërimi i zonës.

Parimi i barazisë para ligjit dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta⁸ si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët.

Dinjiteti i njeriut është një vlerë themelore kushtetuese⁹. Një shoqëri demokratike, që bazohet në dinjitetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë

⁸ Neni 18 i Kushtetutës ka sanksionuar se: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përligje e arsyeshme dhe objektive”.

⁹ Në Preambulën e Kushtetutës deklarohej: “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”.

individët, duhet të garantojë plotësimin e nevojave bazike jetësore për të gjithë. Çdo individ është pjesë e një komuniteti shoqëror të caktuar dhe në këtë kontekst interpretohet edhe dinjiteti i njeriut, si një garanci themelore.

Sipas nenit 116 të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij.

Neni 14, i KEDNJ, “Ndalimi i diskriminimit”, përcakton se: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër”*.

Në çështjen Thlimmenos kundër Greqisë¹⁰, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, ka mbajtur qëndrimin se: *“...kemi një diskriminim kur shteti pa një argumentim objektiv dhe racional e refuzon trajtimin e diferencuar të personave, situata e të cilëve është tepër e ndryshme...”*.

Në interpretim të çështjes së sipërcituar, GJEDNJ përcakton se Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e cila është pjesë e legjislacionit të brendshëm¹¹ dhe jurisprudencës së Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në mbrojtjen nga diskriminimi përfshin jo vetëm detyrimin e trajtimit të barabartë të personave në situata të njëjta, por dhe trajtimin ndryshe të personave në situata të ndryshme.

GJEDNJ-ja në disa raste ka konkluduar se kushtet e mjerueshme të jetesës mund të konsiderohen si trajtim çnjerëzor dhe degradues¹². Gjykata është shprehur se mungesa e aksesit për ujë të pijshëm dhe higjenë çon në trajtim çnjerëzor dhe degradues të njeriut.

Në këtë këndvështrim, mungesa e kanalizimeve të ujërave të zeza, nga ana e Bashkisë Durrës, u ka rrezikuar shëndetin këtyre banorëve dhe i ka vënë në kushtet e një trajtimi të papërshtatshëm dhe degradues. Vazhdimi i kësaj situatë për vite me radhë pa ndërmarrë masa rregulluese, provon se Bashkia Durrës përmes mosveprimit, ka neglizhuar të përmbushë detyrimet ligjore që parashikojnë aktet përkatëse.

¹⁰ Thlimmenos kundër Greqisë, Kërkesa nr. 34369/97, vendimi me datë 06.04.2000.

¹¹ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me Ligjin nr.8137, datë 31.07.1996, hyrë në fuqi në datë 02.08.1996) dhe jurisprudenca e GJEDNJ janë të detyrueshme për tu zbatuar bazuar në nenin 116 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

¹² Çështja “Neshkov dhe të tjerë kundër Bullgarisë” dhe “Jordan Petrov kundër Bullgarisë” dhe “Halil Adem kundër Bullgarisë”.

Referuar nenit 23, pikat 2 dhe 5 të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ku përcaktohen funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, vërejmë se bashkitë janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për: - mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura; dhe - ndriçimin e mjediseve publike.

Kuadri ligjor¹³ ka mirëpërcaktuar se është detyrë e përgjegjësi e Shoqërisë së Ujësjetllës Kanalizimeve (që është në varësi të pushtetit vendor) të sigurojë trajtimin e ujërave të ndotura.

Rregullorja “Për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të Ujësjetllës Kanalizimeve sh.a”, e miratuar me VKM nr. 1304, datë 11.12.2009, ka përcaktuar në mënyrë të qartë dhe të detajuar marrëdhënien ligjore ndërmjet konsumatorëve të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe furnizuesit të këtyre shërbimeve UK sh.a, që vepron në emër të pronarit të aseteve dhe njëkohësisht përgjegjësit ligjor për to, pra Pushteteve Vendore në përbërje të zonës së shërbimit.

Nëpërmjet sanksionit të detyrimeve dhe të drejtave të secilës palë, rregullorja synon, ndër të tjera, dhe një shkarkim efikas mjedisor dhe higjenikisht të përshtatshëm të ujërave të ndotura të zonës duke zvogëluar rreziqet për shëndetin.

Pika 1.2 e kësaj rregulloreje ka përcaktuar se, në përputhje me detyrimin ligjor për të garantuar furnizimin me ujë të pijshëm të popullsisë dhe konsumatorëve të tjerë, si dhe largimin e kontrolluar dhe me rregull të ujërave të ndotura, Bashkia ngarkon për funksionim dhe mirëmbajtje një shoqëri publike të licensuar nga Enti Rregullator Kombëtar i Ujit për këto shërbime. Bashkitë që posedojnë 100% aksione të kësaj shoqërie, me anë të asamblesë së aksionerëve realizojnë vendimmarrjet e rëndësishme për UK sh.a, përcaktojnë natyrën dhe qëllimin e ndërmarrjes si edhe datën e zbatimit, zgjerimin ose riorganizimin e saj. UK sh.a përfaqëson institucionin funksional dhe ekzekutiv që vepron në emër të Bashkisë që ka detyrimet dhe përgjegjësitë publike për shërbimet e furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura në zonën e shërbimit. Objekti i UK sh.a për shërbimet e kanalizimeve të ujërave të ndotura, do të jetë:

- Largimi i kontrolluar i ujërave të ndotura që prodhohen në zonën e shërbimit nga konsumatorët, ;
- Mirëmbajtja e elementëve përbërës të sistemit të kanalizimit;

Bazuar në informacionin e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si dhe faktin që gjendja pranohet nga të dyja palët në proces, konstatohet që gjendja e këtyre banorëve vijon të mbetet e pa zgjidhur.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: “a) barazi

¹³ VKM nr. 1304, datë 11.12.2009 Për miratimin e modelit rregullues “Për furnizimin me ujë dhe kanalizimet në zonën e shërbimit të ujësjetllës kanalizime sh.a”.

përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Në nenin 1 të tij, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Në nenin 20/1, të LMD-së, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“1. Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohej të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.*

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3/1, të LMD-së, të ndryshuar, si vijon: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.*

Gjithashtu, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se trajtimi i diferencuar është diskriminues nëse ai nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, nëse trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim ose nëse nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si institucion i pavarur publik, i cili siguron mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminim, ka mbajtur të njëjtin qëndrim dhe për banorët e pjesës së sipërme të rrugës “Ilir Shehu” në Bashkinë Elbasan, kur me Vendimin nr. 126, datë 20.09.2019, ka konstatuar diskriminim të këtyre banorëve, duke mos ju ofruar shërbimet, për shkak të vendbanimit. Gjithashtu, Komisioneri dhe në rastin e mosofrimit të kushteve të domosdoshme për zhvillimin e arsimit në kuadër të Covid-19, për nxënësit e shkollës 9-vjeçare në fshatin Kllobçisht, Bashkia Dibër, ka mbajtur qëndrim të njëjtë, kur me shkresën nr. 1672, datë 02.12.2020, ka Rekomanduar, në mes të tjerëve, Bashkisë Dibër marrjen e masave me qëllim ofrimin e shërbimeve dhe një mjedisi të sigurt shkollor dhe higjenes për zhvillimin e arsimit në kushtet e pandemisë së shkaktuar nga Covid-19 dhe parandalimin e

diskriminimit për shkak të vendbanimit, për nxënësit e shkollës 9-vjeçare “Kërçisht”, me qendër në fshatin Kllobçisht, Bashkia Dibër.

Në shumicën e çështjeve të diskriminimit, ankuesi e ka të vështirë apo të pamundur t’i mbledhë provat, ndonjëherë provat e drejtpërdrejta as nuk ekzistojnë. Subjektet që konsumojnë sjelljen diskriminuese nuk e pranojnë asnjëherë se kanë diskriminuar. Për të kompensuar këtë disavantazh të madh, legjislacioni ka parashikuar parimin e zhvendosjes së barrës së provës.

Parimi i ndarjes së barrës së provës është shumë i ngjashëm me atë të supozimeve të marra si të vërteta deri në vërtetimin e të kundërtës - “*praesumptio iuris tantum*”.

Kodi i Procedurës Administrative, ka saktësuar se barra e provës në çështjet e diskriminimit të pretenduar, i kalon palës tjetër/organit publik, në këtë rast Bashkisë Durrës, e cila duhet të provojë se banorët e zonës së ish-Kënetës nuk janë trajtuar në mënyrë të pafavorshme, për shkakun e pretenduar.

Kështu, neni 82, pika 2 e tij, përcakton se: *“Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”*.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar në nenin 33/7/1 ka përcaktuar se: *“Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”*.

Parimi i zhvendosjes së barrës së provës është një parim i konsoliduar në legjislacionin e BE-së dhe jurisprudencën e GJEDNJ-së. KEDS¹⁴ gjithashtu ka pranuar që në çështjet e diskriminimit, barra e provës nuk duhet të varet plotësisht nga ankuesi, por duhet të jetë objekt i një rregullimi të posaçëm.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni i ka transferuar barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, ankuesi duhet të krijojë një prezumim të diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm apo të pabarabartë.

¹⁴ Komiteti Evropian për të Drejtat Sociale.

2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.¹⁵

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është bazuar pikërisht në standartin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Gjatë shqyrtimit të ankesës e ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri kishte për synim të siguronte informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës lidhur me rastin në shqyrtim, në mënyrë që të mund të dilte në konkluzione të qarta dhe objektive lidhur me pretendimin e banorëve të zonës së ish-Kënetës për trajtim të disfavorshëm nga ana e Bashkisë Durrës.

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime dhe dokumentacion për ankesën sipërcituar, në mënyrë që Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kishte mundësi të shqyrtonte këtë ankesë, me qëllim marrjen e një vendimi të drejtë dhe të argumentuar në ligj, për konstatimin ose jo të diskriminimit. Komisioneri konstaton se Bashkia Durrës me dijeninë e plotë dhe pas sanksionit me gjobë të dhënë nga Komisioneri me Vendimin nr. 43, datë 11.03.2021, nuk ka ofruar bashkëpunim dhe nuk ka dhënë informacionin dhe dokumentet e kërkuara nga Komisioneri.

Lidhur me sa më sipër, Bashkia Durrës dështoi të provonte para Komisionerit se:

- Ka kryer investime në zonën e ish-Kënetës, lidhur me sistemimin e kanaleve të ujërave të zeza, sigurimin e ndriçimit publik dhe gjelbërimin e zonës krahasuar me investimet e bëra në lagjet e tjera të bashkisë.
- Ka planifikuar investime afatshkurtëra dhe afatmesme për sistemimin e kanaleve të ujërave të zeza, sigurimin e ndriçimit publik dhe gjelbërimin e zonës krahasuar me investimet e bëra në lagjet e tjera të bashkisë.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7/1¹⁶, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, nga analizimi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se banorët e zonës së ish-Kënetës, janë ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Bashkisë Durrës, trajtim i cili ka lidhje me vendbanimin tyre.

¹⁵ https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf, fq.232.

¹⁶ Në nenin 7/1, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 7/1, nenin 20/1, nenin 21/1, nenin 32, pika 1, gërma b), si dhe nenin 33, pikat 2, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit, të banorëve të zonës së ish-Kënetës, në rrugën “Gjelbërimi” dhe rrugën “Azem Hajdari”, për shkak të vendbanimit, nga ana e Bashkisë Durrës.
2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, të merren masa për rregullimin e problematikës së banorëve të zonës së ish-Kënetës nga ana e Bashkisë Durrës.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Bashkia Durrës, të njoftojë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
5. Lënien në fuqi të Vendimit nr. 43, datë 11.03.2021, të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
6. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONER

Robert GAJDA